

Staub: Kushtetuta e vitit `74 njihte mëvetësinë e Kosovës

24/10/2010 - 17:43 | Blerim Shabani

Christian Staub: pjesa normative e Kushtetutës e njihte Kosovën si shtet por Serbia dhe aktet proklamative e kontestonin këtë



© albinfo.ch

Sipas prezantimit që Christian Staub i bëri librit të tij në një promovim që iu organizua nga organizata Pro Integra më 22 tetor në Cyrih, “Kosova ka pasur themelet e një shteti të mëvetësisë, të barabartë me të gjitha republikat e Jugosllavisë së atëhershme, bazuar në pjesën normative të kushtetutës së vitit 1974”. Por, sipas tij, ka qenë pjesa jo normative, ajo deklarative, politike që në praktikë e ka cunuar këtë mëvetësi.

Christian Staub nuk bën pjesë në mesin e studiuesve me karrierë akademike. Por kjo nuk e pengon atë që me përkushtim dhe me akribi shkencore të shkojë në thellësi të problemeve që merr për të studiuar. Preokupim jetësor i tij është Evropa si identitet, si një tërësi që ai e sheh si entitet unik në një të ardhme.

Kosova, si një çështje evropiane, ka hyrë po ashtu në fokusin e z. Staub. Ai, në librin e tij “Kosovo, eine rechtliche Analyse” (Kosova, një analizë juridike) është marrë në thellësi dhe në gjerësi me analizën juridike të kushtetutës së Kosovës të vitit 1974, duke nxjerrë nga aktet e saj normative të drejtën burimore që ka pasur Kosova për mëvetësi.

Pozita dykuptimëshe e krahinave

Staub po ashtu është marrë me dykuptimësinë që ka pasur pozita juridike e krahinave në ish federatën jugosllave. Kosova, ashtu si dhe Vojvodina, kanë gëzuar, sipas Staub një lloj “dyshtetësie”. Kjo, në kuptimin se ato si krahina autonome, kanë pasur përfaqësuesit e tyre si në organet federative ashtu dhe në Republikën e Serbisë. Madje, krahinat kanë gëzuar edhe të drejtën e vetos për vendime të caktuara në nivel të republikës së Serbisë.

Duke u bazuar në këto të drejta specifike, Staub nxjerr konkludimin se Kosova ka pasur mundësi, së paku teorikisht, të shkëpusë raportet me Serbinë dhe t’i referohet vetëm lidhjeve të saj me federatën.

Në lidhje me ndryshimet që ndodhën gjatë fushatës millosheviqiane të fundit të viteve tetëdhjetë, ky studiues, sërish duke iu referuar normave kushtetuese, thotë se “ndryshimet e bëra në kushtetutën e Serbisë në raport me përkatësinë e Kosovës objektivisht, nuk preknin vetë Kosovën. Kjo, sepse Kosova ishte një entitet më vete, i barabartë dhe krejtësisht tjetër nga Serbia. Së këndejmi, ndryshimet në kushtetutën e një vendi nuk kanë si të prodhojnë efekte juridike në një vend tjetër.

Mirëpo, vazhdon Staub në arsyetimin e tij, ajo që ndodhi gjatë fushatës nacionaliste të Millosheviçit ishte përdorimi i kërcënimit me forcë për të realizuar synimet shoviniste serbe për ndërtimin e një “Serbie të plotë”, të një “shteti normal”.

Trajtim i gjatë joparimor i Kosovës nga shtetet evropiane

Duke u bazuar në të drejtat që burojnë nga kushtetuta e vitit 1974, pavarësimi nga çdo tutelë e Serbisë që shpalli Kosova në vitin 1990 del si një fryt legjitim, shikuar nga aspekti juridik kushtetues. Po ashtu, veprimet e mëtejme të Serbisë për të penguar mëvetësinë e Kosovës janë ilegjitime dhe ilegale.

Autori në shpjegimin që i bëri librit të tij u mor edhe me trajtimin jo parimor që shtetet evropiane i bënë Kosovës dhe të drejtës së saj për pavarësi. Kjo u pa përfundimisht në Konferencën e Dejtonit, e cila e la Kosovën jashtë sferës së interesimit të saj. Një trajtim i tillë prodhoi edhe rezistencën e armatosur të shqiptarëve dhe solli në shkallë të fundit edhe zhvillimet që njohim, të vetëdijesimit të perëndimit për rëndësinë e problemit të Kosovës.

Kundrimet e autorit Staub lidhur me aspektet juridike legale të Kosovës që dalin nga kushtetuta e vitit 1974 ngjallën një interes të theksuar në mesin e të pranishmëve. Një numër sish kontribuuan me pyetjet dhe komentet e tyre në sqarimin më të madh të koncepteve, shpesh të panjohura deri më tash, të parashtuara nga Christian Staub në librin e promovuar.

Promovimin e dalloj një organizim me nivel mjaft të lartë. Lanë përshtypje të mirë sidomos prezantimi i autorit Staub nga Osman Osmani, kryetar i Pro Integra-s dhe drejtimi me kompetencë i bisedës me autorin, i bërë nga Faton Topalli.

[Dërgo shkrimin](#) - [Printo](#) - [Shtone komentin tuaj](#)

Lexoni poashtu në kategorinë e njejtë

- Pasaportat – për dy javë!
- Ligji i papunësisë: zbatimi nis në 2011
- Pensionet mbeten pezull - marrëveshja ende askund!
- Zvicra shtohet falë migracionit
- Risitë e ligjit të ri për papunësi
- Kontrata për Lizing, sa kushton?
- Zvicra e vogël dhe ekskluzive
- Kryqi i Kuq: Nuk do të vëzhgojmë kthimin e të dëbuarve nga Zvicra
- Kriza ekonomike detyron zviceranet t'i kthehen atdheut
- Midis projektit dhe kundër-projektit, debati tashmë ka filluar

[Contact](#) | [Karta](#)

Copyright © 2010 albinfo.ch. All Rights Reserved.

Përdorimi i shkrimeve, fotografive si dhe materialeve të kësaj platforme mund të bëhet vetëm duke e përmendur burimin albinfo.ch. Cdo shfrytëzim dhe riprodhim i tyre pa lejen e albinfo.ch është i ndaluar dhe përbën shkelje e të drejtave autoriale .

Redaksia e mban të drejtën për mosbotimin dhe moskthimin e dorëshkrimeve, fotografive apo materialeve të tjera të dërguara.

Powered by [Drupal](#)